

L I G J
Nr.9089, datë 26.6.2003

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.8553, DATË 25.11.1999 "PËR POLICINË E SHTETIT",
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8933, DATË 25.7.2002**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", ndryshuar me ligjin nr.8933, datë 25.7.2002 pas kreut VIII shtohet kreu VIII/a me këtë përmbajtje:

"KREU VIII/A
BASHKËPUNIMI ME KQZ-NË

Neni 60/a

Angazhimi i policisë në zgjedhje

1. Në të gjitha llojet e zgjedhjeve që zhvillohen në Shqipëri, rendi dhe siguria gjatë periudhës zgjedhore ruhen vetëm nga forcat e Policisë së Rendit dhe të Policisë së Objekteve.

2. Përdorimi i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë dhe atyre speciale, Policisë Kriminale dhe asaj Kufitare në ngjarje që kanë të bëjnë me zgjedhjet, me veprime që mund të ndikojnë në intimidimin e zgjedhësve, ose në çfarëdo lloj forme që mund të kushtëzojë vullnetin e tyre, është i ndaluar. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është i detyruar që për të gjithë kohëzgjatjen e periudhës të dorëzojë menjëherë në KQZ një kopje të çdo urdhri për angazhimin e këtyre forcave në zbatim të detyrave të tyre ligjore.

3. Garda e Republikës mban në ruajtje objektet dhe personalitetet që ka në ngarkim edhe gjatë periudhës zgjedhore.

4. Përdorimi i Forcave të Policisë së Rendit dhe të Policisë së Objekteve në zgjedhje bëhet në përputhje me kushtet dhe kërkesat e këtij kreu dhe të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 60/b

Organizimi i policisë në zgjedhje

1. Jo më vonë se 60 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është i detyruar t'i paraqesë KQZ-së listën e plotë të punonjësve të ngarkuar me detyra gjatë zgjedhjeve.

2. Për secilin nga punonjësit e përfshirë në listë, duhet të përcaktohet me shkrim përveç të dhënave personale edhe detyra, grada që mban, vendvendosja e punonjësit gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe në ditën e votimit, emri i epërsisë së drejtpërdrejtë të tij, si dhe në mënyrë të detajuar rrethi i detyrave të ngarkuara.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është i detyruar të informojë menjëherë KQZ-në për të gjitha ndryshimet që i shkaktohen listës ose të dhënave të përfshira në të.

Neni 60/c

Armatimi i policisë në zgjedhje

1. Punonjësit e Forcave të Policisë që ngarkohen me detyra gjatë zgjedhjeve pajisen vetëm me armatim personal brezi (pistoletë). Punonjësit e shërbimit lejohen që përveç armatimit personal të brezit të mbajnë edhe automatik në rastet kur:

a) ngarkohen me ruajtjen e qendrës së votimit gjatë natës përpara ditës së votimit deri në momentin e hapjes së qendrës së votimit;

b) ngarkohen me shoqërimin e kutive dhe materialeve të votimit nga qendra e votimit në KZZ ose KZQV vetëm për momentin e shoqërimit.

2. Përveç rasteve të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, punonjësit e Forcave të Policisë që ngarkohen me detyra gjatë zgjedhjeve në 24 orët para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve qëndrojnë brenda komisariateve ose në vende dislokimi larg qendrave të banuara. Qarkullimi i tyre brenda territorit zgjedhor bëhet vetëm me furgona policie dhe vetëm në rast se kërkohet ndërhyrja e tyre nga KQZ-ja ose nga KQV-ja në zbatim të neneve 101 dhe 102 të Kodit Zgjedhor.

Neni 60/ç

Paraqitja e efektivave me uniformë në zgjedhje

Të gjithë punonjësit e Forcave të Policisë të përfshirë me detyra gjatë zgjedhjeve janë të detyruar të mbajnë në publik gjatë gjithë periudhës së zgjedhjeve shenja të posaçme dalluese, forma dhe përmbajtja e të cilave përcaktohen nga KQZ-ja. Në këto shenja duhet të përfshihet medoemos emri i punonjësit, fotografia, numri personal i identifikimit me jo më shumë se katër shifra, si dhe detyra specifike që kryen."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3895, datë 17.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**